

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7181  
E enjte, 9 maj 2024  
Çmimi 0.50 €

## Escobari: Ka shqetësime se Kosova mund të mos i ketë votat për anëtarësim në KiE



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

ASOCIACIONI VIHET KUSHT PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS (KIE)

# KURTI: KOSOVA S'E PRANON ASOCIACIONIN SI KUSHT PËR ANËTARËSIM NË KIE

FAQE 4-5



Kryeministri Albin Kurti për herë të parë e ka pranuar se Kosovës i është vënë një kusht i ri për anëtarësim në Këshillin e Evropës (KIE). Ai ka thënë se ky kusht ka të bëjë me çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë

se Kosova nuk e pranon Asociacionin si kusht për anëtarësim në KE. "Qeveria nuk e pranon kushtëzimin e anëtarësimit në KIE me Asociacion. Për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë ne bisedojmë në Bruksel e jo në

Strasbourg", ka thënë Kurti. Pas këtij qëndrimi të Kurtit kanë reaguar përfaqësuesit e partive opozitare, të cilët e kanë akuzuar kryeministrin për kurthimin e Kosovës. Ata kanë thënë se Kurti është duke i bërë vendit dëme të mëdha

## AKTUALE



PËRKUJTOHEN DHE NDEROHEN DËSHMORËT E MARTIRËT E FSHATIT SARADRAN TË ISTOGUT F. 7

MINISTRI MAQEDONCI: DO T'I VAZHDOJMË INVESTIMET NË FSK F. 3

DURMISHI NË CILËSINË E TË DYSHUARIT INTERVISTOHET NGA PROKURORIA SPECIALE F. 7

## EKONOMI



KOMISIONI PËR BUXHET NUK I JEP MBËSHTETJE PROJEKTLIGJIT PËR BANIM SOCIAL F. 8

SHUMË SHPEJT NISIN SHËRBBIMET AJRORE NË MES TË KOSOVËS DHE ARABISË SAUDITE F. 8

## SPORT



TREPÇA - YLLI, SONTE FINALJA E PARË F. 12

## GJYKIMI NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së VAZHDON MË 21 MAJ

F. 3



## OSMANI: TEKSASI, SHTËPI E DYTË PËR BASHKATDHETARËT NGA KOSOVA

F. 4-5



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Vazhdojnë protestat kundër projektligjit për “agjentët e huaj” në Gjeorgji

**Tbilisi, 8 Maj** - Protestat kundër të ashtuquajturit projektligji për “agjentët e huaj”, i cili pritet të kalojë në leximin përfundimtar në Parlamentin e Gjeorgjisë, kanë vazhduar në kryeqytetin gjeorgjian.

Qytetarët gjeorgjianë kanë marshuar në kryeqytet në shenjë kundërshtimi të vendimeve të qeverisë për të sjellë legjislacione të cilat rrezikojnë demtimin e marrëdhënieve të Tbilisit me Perëndimin.

Ata kanë marshuar nga ndërtesa e Parlamentit në drejtim të zyrave qendrore të partisë në pushtet, Ëndrra Gjeorgjiane, ku u përballën me një kordon policor.

Disa prej tyre bartnin flamuj të BE-së dhe të Gjeorgjisë. Nuk është raportuar për dhunë. Në

protestat tashmë javore kundër, siç e quajnë kritikët “ligji rus”, ka pasur nganjëherë edhe veprime të ashpra policore për shpërndarjen e turmave. Raportohet se ka pasur përdorim të plumbave të gomës, arrestime dhe banda të cilat i kanë sulmuar demonstruesit. Një prej organizatorëve të protestës më të fundit, Zviad Tsetskhladze, ka thënë se kundërshtarët e projektligjit e kanë krijuar një grup, i cili do të përpiqet të sigurojë mbështetje financiare për individët të cilët pushohen nga puna e tyre në sektorin publik për shkak të kundërshtimit të projektligjit. Dhjetëra mijëra gjeorgjianë kanë dalë në rrugët e Tbilisit dhe të qyteteve të tjera në protestat të cilat kanë hasur në përgjigje të



ashpër policore, si sprej kimik dhe gaz lotsjellës, topa uji dhe, siç dyshohet, edhe plumba gome. Projektligji i detyron mediet dhe organizatat joqeveritare dhe jofitimprurëse të regjistrohen si

“ndjekëse të interesave të një pushteti të huaj”, nëse më shumë se 20 për qind e të ardhurave të tyre vijnë nga jashtë. Qeveria ngul këmbë se ligji do të jetë në përputhje me standardet e BE-së dhe se qëllimi i vetëm i tij

është rritja e “transparencës” dhe parandalimi i “ndikimit të dëmshëm nga jashtë” në skenën politike të vendit.

Projektligji pritet të hidhet në votim për leximin e tretë dhe të fundit deri më 13 maj. Ëndrra Gjeorgjiane dhe aleatët e saj duket se i kanë votat e mjaftueshme për ta kaluar këtë projektligj dhe, mbase, edhe për ta rrezuar veton, të cilët presidentja Salome Zourabichvili është zotuar se do ta përdorë.

Liderët e BE-së kanë thënë se zbatimi i këtij ligji do të ndikojë në shpresat e Gjeorgjisë për t’iu bashkuar bllokut. Projektligji është dënuar edhe nga ShBA-ja, e cila ka qenë mbështetëseja më e madhe e ish-republikës sovjetike në vitet e fundit.

## Kryeministrja e Lituanisë: Të gatshëm për të dërguar ushtarë në Ukrainë



**Vilnius, 8 Maj** - Lituania është gati t’i dërgojë ushtarët e saj në Ukrainë në një mision stërvitor. Lajmi është bërë me dije nga kryeministrja e Lituanisë, Ingrida Simonyte, në një intervistë për “Financial Times”, duke specifikuar se ajo ka “leje” nga parlamenti për të vazhduar, por se Kievi nuk e ka kërkuar ende.

Masa do të shihej nga Kremli si një provokim, por “nëse do të mendonim vetëm për përgjigjen

ruse, nuk mund të dërgonim asgjë”, ka shpjeguar Simonyte. E pyetur për stërvitjet bërthamore të kryera nga Moska, udhëheqësja e qeverisë lituaneze ka thënë se dyshonte nëse armët do të përdoshin, pasi pasojat do të preknin edhe vetë Rusinë. “Shumicën e kohës erërat fryjnë nga perëndimi në lindje”, ka thënë ajo.

Simonyte më pas ka minimizuar raportet se Vilnius kishte ndihmuar Kievin të kthente

burra të moshës luftarake në një përpjekje të dëshpëruar për të rekrutuar më shumë ushtarë.

“Ne nuk do të organizojmë deportime ose do të kërkojmë për burra ‘refugjatë’ ukrainas në vend sepse nuk do të ishte e ligjshme”, tha kryeministrja, duke kujtuar se BE-ja u garantoj atyre mbrojtje deri në mars 2025. Megjithatë, ka shtuar ajo, ata që i shmangën shërbimit ushtarak mund t’u mohohet qëndrimi i përhershëm.

## Freedom House shpallet “organizatë e padëshirueshme” nga Rusia

**Moskë, 8 Maj** - Rusia ka shpallur “organizatë të padëshirueshme” grupin për të drejtat e njeriut, Freedom House. Ky vendim mund të vendosë këdo që punon ose bashkëpunon me OJQ-në në rrezik ndëshkimi nga autoritetet.

Freedom House, me bazë në Uashington, është themeluar më 1941 dhe njihet për avokim politik në lidhje me çështjet e demokracisë, të drejtave politike dhe lirive të njeriut. Në

raportin e saj më 2024, Freedom House e ka cilësuar Rusinë vend të “pasigurt”, duke e vlerësuar atë me vetëm 13 pikë nga 100 të mundshme për Lirinë Globale. “Që kur regjimi filloi një pushtim në shkallë të plotë të Ukrainës në shkurt 2022, autoritetet kanë shtuar kufizimet mbi të drejtat dhe liritë individuale me qëllim që ta mbysin mospajtimin e brendshëm”, është thënë në deklaratë.

Ligji “organizatë e padëshirueshme”, i miratuar më 2015, vë në shënjestër organizatat joqeveritare të cilat financohen nga jashtë.

Zyrtarët rusë e kanë përdorur këtë ligj për t’i marginalizuar dhjetëra organizata të huaja në Rusi. Kjo nënkupton që një organizatë nuk mund të operojë në Rusi dhe qytetarëve të Rusisë u ndalohet bashkëpunimi me të, në të kundërtën rrezikohen të ndiqen penalisht.



## Australia kundër ofensivës në Rafah: Shkatërruese për civilët



**Canberra, 8 Maj** - Ministrja e Jashtme australiane Penny Wong ia ka përsëritur Izraelit kundërshtimin e saj ndaj ofensivës tokësore në Rafah, duke denoncuar efektet e mundshme “shkatërruese”

mbi civilët. “Më shumë se gjysma e 2.3 milionë njerëzve të Gazës po strehohen në Rafah, duke u shpëtuar luftimeve diku tjetër. Ndikimet mbi civilët palestinezë nga një operacion

ushtarak në shkallë të gjerë do të ishin shkatërruese”, ka thënë ajo.

Canberra vazhdon “të bëjë thirrje për një armëpushim humanitar për ta lejuar lirinë e pengjeve dhe

rrjedhjen e lirë të ndihmës” dhe mbështet “punën e vazhdueshme të Katarit, Shteteve të Bashkuara dhe Egjiptit për të ndërmjetësuar një marrëveshje”, përfundoi Wong.



## Gjykimi ndaj liderëve të UÇK-së vazhdon më 21 maj

HAGË, 8 MAJ - Gjykimi ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UCK) do të vazhdojë më 21 maj, pasi trupi gjyqësor për dëshmitarin e 62-të ka thënë se dëshmitë e kaluara të tij mund të vendosen në prova. Lajmin e ka dhënë për "Albanian Post" zëdhënësi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS),

Christopher Bennett. "Sot apo të premten nuk ka asnjë proces gjyqësor. Dje kryetari i trupit gjyqësor njoftoi se procedura është anuluar pasi mbrojtja ka thënë se nuk do të ketë pyetje për dëshmitarin e caktuar (02486), me rezultat që dëshmitë e mëparshme të dëshmitarit mund të futen në provë.

Procedurat gjyqësore do të rifillojnë të martën, më 21 maj", ka thënë Bennett. Dy dëshmitarët e fundit në Speciale kanë dëshmuar në seanca të mbyllura. Në gjykimin e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mbrojtja e Rexhep Selimit, Eric Tully, ka kërkuar që një prej

dëshmitarëve që do të dëgjohet javën e ardhshme të mos ketë vlerë provuese. Këtë mbrojtja e ka kërkuar pasi që të njëjtëve nuk u ishte dhënë prova materiale, ndërkaq dëshmitari të njëjtat i ka analizuar gjerë e gjerë. Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe

Jakup Krasniqi, janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar që në prill të vitit 2023. Deri më tani janë dëgjuar mbi 60 dëshmitarë. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë deklaruar të pafajshëm në raport me akuzat e Gjykatës Speciale.



## Ministri Maqedonci: Do t'i vazhdojmë investimet në FSK



PRISHTINË, 8 MAJ - Në margjinat e forumit "Defense 24", i cili është mbajtur në Poloni, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka takuar zëvendësministrin e Lituaniës, Zhilvinas Tomkus. Ai ka takuar edhe zëvendësministrin e Koresë së Jugut, Sung IL, ish-ministrin e Mbrojtjes të Polonisë si dhe anëtarin e Parlamentit, Mariusz Błaszczak. Me zëvendësministrin e Koresë së Jugut, Maqedonci ka bërë me dije se ka diskutuar rreth formave se si mund të vendoset bashkëpunimi ushtarak ndërmjet Kosovës dhe Koresë së Jugut, me theks të veçantë në

industrinë e mbrojtjes. "Po ashtu, vizitova shtandet e kompanive prodhuese të industrisë së mbrojtjes të cilat prezantonin produktet e teknologjisë së fundit. Në tre vitet e fundit kemi investuar në ngritjen e kapaciteteve të ushtrisë sonë shumëfish më shumë se pesëmbëdhjetë vitet e kaluara. Do të vazhdojmë investimin në përputhje me planin operacional, kërkesat dhe nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Që nga viti 2025 do të hyjmë në fazën e tretë të implementimit të PGjT-së. Fazë tjetër, investime të reja", ka shkruar Maqedonci në "Facebook".

## Osmani: Teksasi, shtëpi e dytë për bashkatdhetarët nga Kosova

TEKSAS, 8 MAJ - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të mërkurën në ShBA guvernatorin e Teksasit, Greg Abbott. Ajo ka bërë me dije se me guvernatorin e Teksasit ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit në fushën e tregtisë dhe fushave të tjera me interes të përbashkët të të dyja

vendeve. "Kënaqësi që takova guvernatorin e Teksasit, Greg Abbott, me të cilin diskutuam për thellimin e bashkëpunimit në fushën e tregtisë, investimeve të jashtme, bujqësisë, teknologjisë informative, arsimit dhe fushave të tjera me interes të përbashkët. Teksasi është bërë shtëpi e dytë për

bashkatdhetarët tanë nga Kosova, duke u ofruar perspektivë, kushte për jetë cilësore dhe biznes produktiv. E falënderoj guvernatorin për vendimin që ma dorëzoi sot nëpërmjet të cilit nderohet dhe shënohet 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë sonë, në Teksas", ka shkruar Osmani në "Facebook".







ASOCIACIONI VIHET KUSHT PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS (KiE)

## Kurti: Kosova s'e pranon Asociacionin si kusht për anëtarësim në KiE

Kryeministri Albin Kurti për herë të parë e ka pranuar se Kosovës i është vënë një kusht i ri për anëtarësim në Këshillin e Evropës (KiE). Ai ka thënë se ky kusht ka të bëjë me çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se Kosova nuk e pranon Asociacionin si kusht për anëtarësim në KE. “Qeveria nuk e pranon kushtëzimin e anëtarësimit në KiE me Asociacion. Për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë në bisedojmë në Bruksel e jo në Strasburg”, ka thënë Kurti. Pas këtij qëndrimi të Kurtit kanë reaguar përfaqësuesit e partive opozitare, të cilët e kanë akuzuar kryeministrin për kurthimin e Kosovës. Ata kanë thënë se Kurti është duke i bërë vendit dëme të mëdha

ka thënë Kurti.

Në këtë kontekst, Kurti ka ngulur këmbë se qeveria e tij nuk do ta pranojë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si kusht për anëtarësimin e Kosovës në KiE.

Duke folur para ministrave, Kurti ka thënë se Kosova është duke u përballur javët e fundit me “një kusht të ri, i cili nuk ka të bëjë aspak me anëtarësimin” në Këshillin e Evropës. “Qeveria nuk e pranon kushtëzimin e anëtarësimit në Këshill të Evropës me Asociacion. Për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë bisedojmë në Bruksel, jo në Strasburg. Neni 7 i marrëveshjes bazike edhe në ndërlidhje me nenin 10 nuk mund të nxirret jashtë marrëveshjes, nuk mund të vendoset në qendër të saj dhe as sipër saj si një çështje urgjente”, ka thënë Kurti.

Ai ka bërë me dije se e kishte refuzuar draft-statutin e Asociacionit të propozuar nga emisari i Bashkimit Evropian (BE), Miroslav Lajçak, në tetor të vitit të kaluar. “Ky dokument i sjellë te ne nga përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialog, Miroslav Lajçak, së bashku me këshilltarët diplomatikë të shteteve të Quintit, nuk u pranua më 26 tetor të vitit të kaluar. Kosova ka ofruar që ai dokument të bëhej pjesë e pakos së

marrëveshjes bazike të Brukselit dhe aneksit të zbatimit të Ohrit, që është pjesë integrale e tij dhe të nënshkruhet për t'u bërë ligjorë dhe i obligueshëm dhe i zbatueshëm. Por, u pat refuzuar nga Serbia. Refuzimi nuk është pranim. Refuzimi është refuzim. Nëse me datë 26 tetor 2023 do të pranohej e nënshkruhej paketa e marrëveshjes në Bruksel, vetëm atëherë ai draft-statut do të mund të dërgohej në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Draft-statuti i Lajçakut dhe emisarëve të tjerë të Quintit si dokument dështoi të zyrtarizohej pasi u refuzua. Si i tillë është një jo-dokument, pra një ‘non-paper’. Qeveria e Kosovës nuk mund të dërgojë dokumente të cilat nuk i ka pranuar e nuk janë zyrtare në Gjykatë Kushtetuese. Kjo kërkesë ndaj nesh ka qenë dhe mbetet absurde”, ka thënë Kurti.

Më tutje, Kurti ka këmbëngulur se Kosova e meriton anëtarësimin në KiE pasi, sipas tij, i ka “plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme tashmë”. “Qeveria ka punuar pa reshtur dhe ka bërë çdo veprim për t'i plotësuar standardet, kriteret, kushtet e parakushtet për t'u bërë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës. Ne duam anëtarësim meritore, sepse konsiderojmë që ne e meritojmë anëtarësimin në Këshillin e Evropës, meqenëse ndajmë vlerat

e përbashkëta dhe i plotësojmë standardet e kërkuara. Anëtarësimin në këtë organizatë e shohim sidomos për nga përfitimet që sjellë për qytetarët, veçanërisht për komunitetet joshumicë, duke u dhënë qasje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo e drejtë dhe kjo mundësi nuk bën të kufizohet dhe refuzohet duke vonuar anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë”, ka deklaruar Kurti. Kosova dhe Serbia ishin pajtuar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe qysh në vitin 2013. Megjithatë, qeveri të njëpasnjëshme të Kosovës kanë refuzuar ta zbatojnë marrëveshjen, duke shprehur frikë se asociacioni i tillë njëntik mund të ndikojë në funksionalitetin e duhur të shtetit.

Pas trysnisë së vazhdueshme, diplomatët perëndimorë kanë hartuar një draft-statut të këtij asociacioni, të cilin ia kanë dorëzuar Kosovës dhe Serbisë në fund të vitit të kaluar. Më 27 mars të këtij viti Komiteti për Politikë dhe Demokraci i Këshillit të Evropës ka miratuar raportin e raportueses për Kosovën, Dora Bakoyyanis, e cila ka thënë se vendi i ka plotësuar kushtet për t'u bërë anëtar me të drejta të plota i organizatës, ndërsa Asociacionin e ka konsideruar

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 8 maj - Republikës së Kosovës i është vënë kusht Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në këmbim të anëtarësimit në Këshillin e Evropës (KiE). Këtë kusht të ri për herë të parë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka përmendur të mërkurën në mbledhjen e qeverisë. “Pengesat për anëtarësim në këtë organizatë i mendonim nga shtetet të cilat deri më tani nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, por assesi dhe asnjëherë nuk e mendonim që pengesë do të bëheshin shtetet demokratike të cilat kanë qenë

dhe vazhdojnë të jenë përkrahëse të Kosovës për zhvillim e demokratizim, e më herët ishin krahë nesh për çlirim e pavarësim. Plotësimi i kriterëve për anëtarësim në Këshill të Evropës, që mori 82 për qind të votave të Asamblesë së Parlamentare, 25 vjet pas gjenocidit të Serbisë ndaj Kosovës dhe 16 vjet pas shpalljes së pavarësisë, është moment i festimit të arritjeve dhe moment krenarie për çdo qytetar të saj dhe për të gjithë aleatët, miqtë dhe mbështetësit e Kosovës. Mungesa e përkrahjes është për keqardhje. Nuk do t'i ndihmojë normalizimit e dialogut dhe nuk i kontribuon demokracisë, paqes dhe sigurisë”,



# Escobari: Ka shqetësime se Kosova mund të mos i ketë votat për anëtarësim në KiE



WASHINGTON, 8 MAJ - I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë kërkuar që Kosova të themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Gjatë një bisede me gazetarë, Escobari ka thënë se çështja e Asociacionit dhe e disa çështjeve që kanë të bëjnë me minoritetet, që nuk janë përmbushur, kanë qenë kërkesa të vazhdueshme. "Ka shqetësime që Kosova mund të mos ketë votat për Këshillin e Evropës", ka thënë Escobari. Ai ka thënë se ShBA-ja nuk ka

votë në këtë organizatë evropiane për të drejtat e njeriut, por qëndrimi i amerikan është që Kosova duhet të jetë anëtare me të drejta të plota e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Gjatë kësaj bisede virtuale me gazetarë, Escobari, që në fund të këtij muaji përfundon mandatin e tij, ka thënë se i vjen keq që gjatë mandatit të tij nuk është zbatuar marrëveshja në rrugën drejt normalizimit të raporteve, e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë vitin e kaluar. Ai i ka fajësuar të dyja shtetet për dështim të përmbushjes së zotimeve të tyre që dalin nga kjo marrëveshje dhe aneksi për zbatimin e saj.



çështje të brendshme të Kosovës. Më pas, më 16 prill, raporti i Bakoyyanisit ka kaluar edhe në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ndërsa vendimin përfundimtar do ta marrë Komiteti i Ministrave, saktësisht një muaj më vonë. I përbërë prej 46 shtetesh anëtare, 27 prej të cilave anëtare të Bashkimit Evropian, Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Serbia ka njoftuar së voni se ka ngritur një grup punues për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Kjo, pavarësisht marrëveshjes që ajo ka me Kosovën, për të mos e kundërshtuar anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare.

## Kushtëzimi i rrugës së Kosovës për KiE, Musliu-Shoshi: Qëllimi i LV-së është zhbërja e shtetit të Kosovës

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ariana Musliu-Shoshi, ka reaguar pasi kryeministri Albin Kurti e ka pranuar se rruga e Kosovës drejt Këshillit të Evropës është kushtëzuar me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka bërë me dije se partia në pushtet nuk beson në shtetin e

Kosovës. Musliu-Shoshi ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje është në pushtet për ta realizuar qëllimin e saj kundër shtetit të Kosovës. "Të falat që Albini ia adreson Parisit e Berlinit nuk më befasonin sepse LV-ja nuk ka besuar as nuk beson në Kosovën shtet fuqplotë e të



përhershëm! Këtu janë për ta realizuar qëllimin e tyre, pra zhbërjen e Kosovës. Kaq, nuk pres më shumë!", ka shkruar ajo në "Facebook".

## Hoti: Qeveria Kurti i ka bërë dëm të madh dhe afatgjatë integrimit euroatlantik të Kosovës

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se qeveria Kurti i ka bërë

dëm të madh dhe afatgjatë integrimit euroatlantik të Kosovës. Këtë deklaratë Hoti e ka bërë pasi kryeministri Albin Kurti ka pranuar që Asociacioni është kusht për anëtarësimin e vendit në Këshillin e Evropës. Ai ka renditur në "Facebook" disa veprime të Kurti që kanë çuar në vendosjen e këtij kushti. "Qeveria aktuale në fillim të mandatit e braktisi dialogun për njohje reciproke, të nisur në qeverinë paraprake me mbështetje të aleatëve. Vendosi kushte për dialog, të cilat nuk u morën parasysh as nga ndërmjetësi i BE-së, as nga aleatët. E nisi dialogun pa kushte. E pranoi marrëveshjen e Brukselit/Ohrit, e cila në qendër nuk e ka njohjen reciproke, por i ka garantitë për vetëmenaxhim për komunitetin serb dhe kishën ortodokse serbe.

## Molliqaj: Kushtëzimi i Kurtit, kushtëzim për Kosovën

Në lidhje me kushtëzimin e Kosovës për anëtarësim në KiE ka reaguar edhe lideri i PSD-së, Dardan Molliqaj. Ai ka thënë se kushtëzimet e kryeministrit Albin Kurti janë kthyer në kushtëzim për Kosovën. "Kurti ka dërguar letër për anëtarësim në

tyre për mbështetje të anëtarësimin të Kosovës në Këshillin e Evropës. Diskutimi me arrogancë kishte arritur edhe në nivel të toneve të larta, madje vetëm fjala 'pushtues' mungoi! Arroganca e 3 prillit e dobësoi vlerën e letrës së garancive të datës 22 mars 2024", ka shkruar Ramadani në "Facebook". Ai ka treguar se në reagimin e qeverisë ka një mosqartësim serioz dhe të qëllimshëm.



Këshillin e Evropës ku zotohet se do t'i plotësojë kërkesat politike që vijnë nga dialogu i Brukselit. Sot po ankohet që anëtarësimi i Kosovës në Këshill të Evropës po ndërlikohet me dialogun e Brukselit. Kushtëzimet e Kurtit u shndërruan në kushtëzime për Kosovën", ka shkruar Molliqaj në "Facebook".

Kushtet e aleatëve ndaj Kosovës i ka komentuar edhe ish-kryeinspektori i AKI-së, Burim Ramadani. Ai ka thënë se kushtëzimi ka ndodhur për shkak të arrogancës së kryeministrit Albin Kurti dhe presidentes Vjosa Osmani ndaj ambasadorëve të vendeve të Quintit. "Osmani e Kurti ishin shumë arrogantë ndaj ambasadorëve të Quintit gjatë takimit më 3 prill 2024. Atë ditë ambasadorët e Quintit paraqitën kushtin e shteteve të

"Dërgimi i draft-statutit në Gjykatë Kushtetuese nuk është kusht për anëtarësim në KiE, por është kusht i disa shteteve për të votuar Prof. Pra, ka dallim thelbësor! Kushdo mund të bëjë kallaballëk fjalësh, por sikurse jemi mësuar, assesi s'po mund ta thonë troç të vërtetën! E vërteta është se ky paraqet një dështim serioz diplomatik të Kosovës! Kosova ka dështuar të merr mbështetjen e shteteve të Quintit që janë anëtare në KiE për të votuar pro anëtarësimin të Kosovës! Ka dështuar t'i bind këto shtete për të marrë votën e tyre! Me arrogancë nuk binden, por me argumente të qëndrueshme. Po të largonin arrogancën, jam i bindur se 4 shtetet e Quintit në KiE do të ishin fleksibile në raport me draft-statutin!", ka shkruar Ramadani.



## Policia, EULEX-i dhe KFOR-i përfundojnë stërvitjen "Shpata e Artë 2024"



PRISHTINË, 8 MAJ - Policia e Kosovës, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe misioni i KFOR-it, të udhëhequr nga NATO, kanë përfunduar stërvitjen "Shpata e Artë 2024".

Sipas një komunikate të lëshuar nga KFOR-i, stërvitja ka demonstruar një aftësi të zgjeruar për të kryer detyra

të përbashkëta në përgjigje të skenarëve të ndryshëm të sigurisë. "Përfundimi i stërvitjes 'Shpata e Artë 2024' paraqet një moment historik të rëndësishëm në bashkëpunimin afatgjatë ndërmjet këtyre tre entiteteve drejt sigurisë së qëndrueshme në mbarë Kosovën. Përkushtimi, profesionalizmi dhe fryma e bashkëpunimit e shfaqur

nga të gjithë pjesëmarrësit kanë qenë shembullore. Angazhimi ynë për të kontribuar në stabilitetin rajonal është i palëkundur. Së bashku do të vazhdojmë ta japim kontributin tonë drejt një të ardhmeje të sigurt dhe stabile për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë", ka thënë komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulutas.

## Bie kërkesa për aplikim për dokumente, kthehet orari i rregullt i punës

PRISHTINË, 8 MAJ - Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) ditë më parë kishte marrë vendim që të gjitha qendrat për pajisje me dokumente gjatë ditëve të punës të punojnë me orar të zgjatur, mirëpo nga mërkura do të punohet sërish me orar të rregullt. Kështu ka bërë me dije përmes një njoftimi Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

Ky vendim është marrë bazuar në procesin e punës të departamenteve përkatëse për rënie të kërkesave për aplikim për dokumente. "Nga sot (e mërkurë) në të gjitha qendrat për pajisje me dokumente do të punohet me orar të rregullt.

Agjencia e Regjistrimit Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme do të ndërpresë punën me orar të zgjatur nga dita e sotme. Ky vendim është marrë bazuar në procesin e punës të departamenteve përkatëse për rënie të kërkesave për aplikim për dokumente, andaj bazuar në këtë trend është marrë vendim që të punohet vetëm me orar të rregullt", ka njoftuar MPB-ja.

Më tutje është thënë se vetëm edhe këtë javë do të punohet edhe ditën e shtunë. "Në qendrat për pajisje me dokumente do të punohet vetëm edhe këtë të shtunë, datë 11.05.2024 dhe do të punohet nga ora 08:00 deri në orën 16:00", ka njoftuar MPB-ja.



## Haradinaj në Gjakovë: Gjini, model i kryetarit të suksesshëm dhe qeverisjes shembullore



GJAKOVË, 8 MAJ - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar sot Gjakovën. Ai është pritur nga i pari i kësaj komune, Ardian Gjini.

Haradinaj ka thënë se Gjakova është shndërruar në një vend atraktiv për bizneset dhe qytetarët. "Kryetari Ardian Gjini me qeverisjen në Gjakovë është model i kryetarit të suksesshëm dhe qeverisjes shembullore, duke u ofruar qytetarëve të saj, infrastrukturë dhe projekte të rëndësishme që i kanë dhënë hov zhvillimit të Gjakovës. Gjatë

vizitës në këtë komunë, pamë nga afër punimet në lumin Krena, projekt që ka zgjidhur jo vetëm problemin me ujërat e zeza por është shndërruar në një vend atraktiv për bizneset dhe qytetarët", ka thënë Haradinaj. Haradinaj ka shtuar se Gjakova është vend ku gërshetohen historia, sakrificat dhe traditat e popullit shqiptar. "Po ashtu, bashkë me kryetarin Gjini u pritëm ngrohtësisht nga Shejh Ruzhdi Shehu, në Teqenë Shejh Eminit. Një vend ku gërshetohen historia, sakrificat dhe traditat e popullit shqiptar", është shprehur Haradinaj.

## Miratohet Udhëzimi Administrativ për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës

PRISHTINË, 8 MAJ - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projekt-udhëzimin Administrativ për bashkëpunimin e strukturave dhe mekanizmave institucionalë me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se përmes këtij Projekt-udhëzimi përcaktohen mënyrat e bashkëpunimit. Ajo ka thënë se kështu do të sigurohet zbatim i plotë i politikave. "Ky projekt-udhëzim ka të bëjë me bashkëpunimin e strukturave

mekanizmave institucionalë me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat dhe ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës. Përcakton mënyrat e bashkëpunimit, në mënyrë që të sigurojmë zbatimin e plotë të politikave", ka thënë ministria Haxhiu në mbledhjen e qeverisë.





## Durmishi në cilësinë e të dyshuarit intervistohet nga Prokuroria Speciale

PRISHTINË, 8 MAJ - Zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Hysen Durmishi, është marrë në pyetje nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) në lidhje me tenderin e rrugës Prishtinë - Podujevë. Në një deklaram para gazetarëve, Durmishi ka thënë se ka qenë i ftuar nga ky institucion i ndjekjes në cilësinë e të dyshuarit dhe se nga prokurori i janë bërë pyetje sqaruese. Durmishi ka thënë se ka "sqaruar pastërtinë e plotë" të tij në procesin e ndërtimit të

rrugës Prishtinë - Podujevë. "Unë sot iu përgjigja ftesës së Prokurorisë Speciale. Isha i ftuar në cilësinë e të dyshuarit për rastin e projektit të ndërtimit të rrugës Prishtinë - Podujevë. Kryesisht kjo është fazë fillestare dhe pyetjet e prokurorit ishin pyetje sqaruese të cilat unë i sqarova pothuajse të gjitha pyetjet të cilat i kishte prokurori për ta dëshmuar se procesi për rrugën Prishtinë - Podujevë ka qenë një proces i rregullt dhe se atje po zhvillohen punimet me dinamikën të cilën e kemi planifikuar dhe në një farë mënyre sqarova para prokurorit

pastërtinë e plotë timen në gjithë këtë proces. Bëhet fjalë për një kallëzim penal që e ka bërë një operator ekonomik, ankues në kohën kur janë nënshkruar këto kontrata, e cila është totalisht e pabazuar. Ka vendime edhe të OShP-së, dokumente të cilat janë publike, që dëshmojnë pastërtinë tonë në gjithë këtë proces. Prandaj ishin disa sqarime të prokurorit të cilat ai i mori dhe tash po presim", ka thënë Durmishi. Ai ka theksuar se punimet në këtë aks rrugor do të vazhdojnë dhe do të përfundojnë gjatë këtij viti.



## Përkujtohen dhe nderohen dëshmorët e martirët e fshatit Saradran të Istogut

ISTOG, 8 MAJ - Përfaqësues të institucioneve, partive politike, familjarë dhe veteranë të UÇK-së kanë përkujtuar të mërkurën dëshmorët e martirët e fshatit Saradran të Istogut.

Kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe te lapidari i fshatit Saradran, në 25-vjetorin e masakrës në këtë fshat, si dhe ka vendosur lule të freskëta te lapidari i dëshmorëve Demush Mavraj, Ibish Mavraj dhe Bekim Mavraj.

Teksa ka nderuar të gjithë dëshmorët e martirët e rënë për lirinë e Kosovës, kryeministri Kurti ka folur për masakrën e para 25 vjetëve kur forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe i kishin ndarë 18 burra, 16 shqiptarë dhe dy egjiptianë dhe i kishin pushkatuar.

"Me zëvendësministrin e Industrisë, Ndërmarrësisë e Tregtisë, Mentor Arifajn, me kolegë, me miq e dashamirë, me familjarë të dëshmorëve, martirëve, me banorë të fshatit Saradran porsa vendosëm lule të freskëta te lapidari i tre dëshmorëve Mavraj, Demushi, Ibishi dhe Bekimi, të cilët ranë në ballafaqim me forcat armike serbe para 25 vjetëve.



Paraprakisht ishim edhe tek lapidari i martirëve ku para 25 vjetëve, sërish këtu, te popullsia civile e grumbulluar edhe nga fshatrat e tjera, forcat ushtarake policore, paramilitare serbe i kishin ndarë 18 burra, 16 shqiptarë dhe dy egjiptianë dhe pushkatuar. Kemi dëshmitarë të gjallë. Dëshmitari i gjallë është Naim Elshani, i cili edhe e ka identifikuar njërin prej atyre, mbi 10 ushtarëve, policëve e paramilitarë, që kanë vranë e ekzekutuar, me inicialet E. B., por do të thotë që vetëm një është në arrest prej mbi 30 sosh. Kjo do të thotë se ka nisur drejtësia, por është shumë larg që ta mbyllë

plagën duke i vendosur prapa grilave të gjithë ata të cilët dhanë urdhër dhe ekzekutuar popullsinë civile e të paarmatosur", ka thënë Kurti, duke shtuar se gjaku i dëshmorëve nuk do të shlyhet kurrë. "Të gjithë atyre të cilët ranë në rrugën e gjatë e të vështirë të Kosovës për liri, u qoftë lavdi, dëshmorë e martirë të kombit. Gjaku i tyre nuk shlyhet kurrë. Emri i tyre s'harrohet kurrë. Është pjesë e historisë moderne të Kosovës, gjithashtu është edhe vendi prej nga ushqehet shteti që kemi e liria që e gëzojmë!", ka thënë Kurti.

Dëshmorët e martirët e

Saradranit janë përkujtuar edhe nga zyrtarë të AAK-së. Deputeti i kësaj partie, Bekë Berisha, së bashku me ish-bashkëluftëtarë kanë nderuar të rënë për liri.

### Përkujtohet heroi i Kosovës, Dinë Grabovci

Të mërkurën është përkujtuar heroi i Kosovës, Dinë Grabovci, vëllai i ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Adem Grabovci.

Homazhe te varri i Dinë Grabovcit ka bërë deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti, i shoqëruar nga Adem Grabovci dhe djali i heroit, Valoni. "Sot në kujtim për

Dëshmorët dhe të rënë me 8 maj në Saradran! Lavdi e Përrjetshme!", ka shkruar Valon Grabovci në "Facebook".

Dinë Grabovci ishte veprimtar i lëvizjes kombëtare dhe kontribuues i jashtëzakonshëm i luftës çlirimtare.

Dinë Grabovci, vëllai i të cilit, Adem Grabovci, ishte i burgosur politikë tri herë radhazi, njëherësh ishte edhe një nga pesë nismëtarët e Aksionit të Pajimit të Gjaqeve në vitin 1990 në Kosovë dhe më pastaj një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërkaq e bija e tij, në atë kohë studente, Luljeta, ishte po ashtu një nga pjesëmarrëset më aktive në demonstratat e mbajtura në Pejë si dhe pjesëtarët e para të pajimit të gjaqeve.

Në vitin 1990, kur Kosova ishte ngritur në këmbë me fuqishëm dhe me më vendosmëri se kurrënjherë më parë në kërkim të të drejtave të shkelura dhe lirisë së mohuar nga ana e Beogradit zyrtar, shtëpia e Dinë Grabovcit në Pejë ishte shndërruar në njërën nga pikëtakimet më kryesore dhe, njëherësh, edhe më të sigurta të ish-të burgosurve politikë të kësaj ane.

## Vitia: Në qershor hapet konkursi për 80 specialistë dhe rreth 200 infermierë

PRISHTINË, 8 MAJ - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se investimet në QKUK dhe spitale të përgjithshme po kryhen me ritëm të shtuar dhe se investimet po bëhen edhe në shërbime të reja.

Ministri Vitia ka thënë se deri në muajin qershor do të hapet konkursi për punësimin e mbi 300 profesionistëve shëndetësorë. Në mesin e tyre, do të jenë 80 specialistë dhe rreth 200 infermierë.

"Investimet në infrastrukturë në QKUK dhe në spitalet e përgjithshme po vazhdojnë me intensitet të shtuar për t'i bërë ambientet më miqësore dhe praktike për pacientët. Po investohet edhe në infrastrukturë. Janë hapur shumë shërbime të reja. Edhe shërbime që deri tani nuk janë bërë. Vetëm në Gjinekologji pritet të mundësohen tri shërbime të reja. Shërbimet që janë marrë

në sektorin privat dhe jashtë shtetit, tani do të merren edhe në sektorin publik. Në bashkëpunim me menaxhmentin e ShSKUK-së në muajin qershor do të hapet konkursi edhe për rreth 330 profesionistë shëndetësorë. Do të punësohen rreth 80 specialistë dhe rreth 200 infermierë që do të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve", ka thënë Vitia në një konferencë për medie.





## Shumë shpejt nisin shërbimet ajrore në mes të Kosovës dhe Arabisë Saudite



PRISHTINË, 8 MAJ - Është miratuar nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Shërbime Ajrore në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka bërë me dije se nëpërmjet kësaj nisme, duke pasur

parasysh faktin se zhvillimet në shërbimet ajrore janë thelbësore për zhvillimin ekonomik e kulturor të të dyja vendeve, "miratohet nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Shërbime Ajrore në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite. Nëpërmjet kësaj nisme, pasur parasysh faktin se zhvillimet

në shërbimet ajrore janë thelbësore për zhvillimin ekonomik e kulturor të të dyja vendeve, do të kontribuojmë në rritje të fluksit të vizitorëve dhe realizimin e fluturimeve direkte nga të dyja anët, po ashtu në ofrimin e rritjes së shërbimeve më cilësore dhe të sigurt", ka shkruar ministri Aliu në "Facebook".

## Komisioni për Buxhet nuk i jep mbështetje Projektligjit për Banim Social



PRISHTINË, 8 MAJ - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere të mërkurën ka shqyrtuar projektligjin për ratifikimin e kredisë në mes të Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës për Projektin banim social adekuat.

Ankesa për këtë projekt kanë pasur deputetët e pozitës dhe të opozitës, të cilët kanë kritikuar vonesat për realizimin e këtij projekti. Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se, përveç studimit të fizibilitetit, për këtë projekt nuk ka asnjë studim tjetër të hollësishtëm. "Kreditë po merren pa përgatitjet e nevojshme e pastaj po shtyhet afati i ekzekutimit të tyre. Marrëveshja është miratuar në Këshillin

Administrativ dhe ju e keni nënshkruar në janar. Përgatitjet për këtë projekt janë zero. Është vetëm një studim i fizibilitetit dhe përtej saj nuk ka asnjë studim të realizuar se sa është numri i ndërtesave sociale, sa është kosto, si do të adresohet kjo çështje", tha ai.

Ndërsa zëvendësministri i Ministrisë së Planifikimit Hapësinor, Jeton Raka, ka thënë se përmes grantit në vlerë dy milionë euro do të bëhen renovime të banesave dhe ndërtime të shtëpive për qytetarët, varësisht nga kërkesat e komunave.

"Sigurimi i banimit për qytetarët në nevojë është objektivi kryesor. Kemi dy komponentë kyçe: banimi adekuat social, renovime, banesa ekzistuese, shndërrimi i banesave sociale të reja.

Komponenti i dytë janë shtëpitë individuale, ndërtimi i tyre për familjet me të ardhura të ulëta. Projekti do të zbatohet me komuna. Gjithçka do jetë transparente. Do të bëhet identifikimi i lokacioneve. Pas thirrjes publike komunat do të bëjnë analizën e projektit, një grant prej 2 milionë eurosh që e kemi fituar", ka thënë Raka.

Informacione shtesë ka kërkuar edhe deputeti i Vetëvendosjes, Eman Rrahmani, i cili ka thënë se nuk mund ta mbështesë këtë projekt nëse nuk dihet destinimi i saktë i ndërtesave dhe informacione të tjera të rëndësishme.

"Nuk ka destinim të saktë. Dua të di sa ndërtesa do të ndërtohen në Deçan, sa në Prishtinë? A do të jenë banesat kolektive apo të

shpërndara?", ka pyetur Rrahmani. Kurse zëvendësministri Raka ka thënë se komunat e kanë plotësuar një formular dhe kanë treguar pak a shumë sa janë të gatshme për këtë projekt. Ai ka thënë se nuk duhet të bëhet politikë me kategoritë e ndjeshme pas kritikave që ka marrë nga anëtarët e këtij komisioni. "Projekti do të zbatohet në komuna. Gjithçka do të jetë transparente. Do të bëhet identifikimi i lokacioneve dhe pas thirrjes publike komunat do ta bëjnë analizën e projektit. Sipas ligjit, komunat kanë përgjegjësi të hartojnë raporte për programet trevjeçare për banimin social. Janë diku 17 komuna që i kanë këto programe. Shtatë prej tyre iu ka skaduar programi, tri komuna i kanë vetëm si draft, ndërsa 10 komuna nuk kanë hartuar fare

program", ka thënë Raka.

Më tutje, deputetja Duda Balje ka thënë se ka shumë kërkesa nga qytetarët sepse secila familje dallon nga tjetra sa iu përket nevojave të tyre. Një problem që e ka paraqitur si shqetësues deputetja Balje është se shumë qytetarë, sipas saj, ka mundësi të mos kenë toka të tyre dhe si do të ndërtohet shtëpia e tyre kur ka mungesë të tokave.

Në anën tjetër, kryetari i Komisionit për Buxhet, Armend Muja, ka thënë se duhet të kihet shumë kujdes që si shtet demokratik të mos lënë anash edhe komunitetet sa i përket këtij projekti. Ndërsa pas propozimit të kryetarit Muja është vendosur të ketë edhe një diskutim të kësaj pike të rendit të ditës dhe të merren parasysh kërkesat e të gjithë anëtarëve të komisionit.

## Miratohet Projektligji për Bankat, Murati: Synohet rregullimi i aktivitetit bankar

PRISHTINË, 8 MAJ - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Bankat, i cili synon rregullimin e aktivitetit bankar dhe financiar të bankave në Kosovë në funksion të nxitjes së një sistemi sa më të qëndrueshëm financiar.

Po përmes këtij projektligji rregullohen kriteret për themelimin dhe licencimin e bankave, organizmin dhe menaxhimin e shëndoshë të

tyre, mbikëqyrjen, rimëkëmbjen, përmbylljen dhe likuidimin e tyre.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se ky projektligj përcakton masat përmirësuese dhe gjobat administrative që lidhen me procesin e rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja. "Ky projektligj synon rregullimin e aktivitetit bankar

dhe financiar të bankave në Republikën e Kosovës në funksion të nxitjes së një sistemi sa më të qëndrueshëm financiar, duke siguruar një nivel të duhur të mbrojtjes së interesave të depozitorëve", ka thënë Murati.

Murati ka theksuar se me miratimin e këtij ligji janë rritur kërkesat për kapitalin themeltar për bankat në 10 milionë euro nga 7 sa ishte me ligjin në fuqi.





# Revolucioni i vitit 1821 në Greqi, ishte revolucion i shqiptarëve!

*Ata që u çliruan me gjakun e mundimet tona janë armiqtë më të këqijtë tanë” (Fan Noli)*



**Nga: Alba HARUNI**

Pas revolucionit francez 1789-1799 nisi një epokë e re që tronditi nga themelet Evropën e vjetër. Jehona e tij i dha jetë lëvizjeve të përgjithshme, të cilat kërkonin në bazë të bashkëjetesës politike dhe shoqërore: lirinë, barazinë dhe vëllazërimin e të gjithëve, garancinë dhe pacënueshmërinë e pronës, laicitetin e shtetit, tolerancën fetare, uniformitetin administrativ.

Këto parime u përhapën nga Franca në Evropë nëpërmjet armatave të Napoleonit. Vazhdimi i këtyre ideve ishte epoka e Nacionalizmit dhe e Revolucionit Industrial që mund të konsiderohet si epoka, në të cilën u trondit përfundimisht Evropa e vjetër e aristokracisë, e monarkive absolute, e shoqërive të Regjimit të Vjetër, por në të cilën u shpall njëkohësisht Evropa e kombeve, e regjimeve liberale, konsituacionale dhe parlamentare.

Mbi këtë shtrat historik, mori jetë dhe u zhvillua, i ashtuquajtur Revolucion i Greqisë (1821-1832).

Interesi i Evropës Perëndimore mbi Greqinë e Lashtë krijoi filohelenizmin. Klasa sunduese konservatore e Britanisë në veçanti ishte shumë e interesuar për Greqinë, për shkak të shkollimit të tyre mbi klasicizmin dhe kjo solli mbështetjen e Britanisë për Revolucionin Grek për pavarësi. Në fakt, termi grek në shekullin XIX ka patur domethënie politike dhe jo atë kombëtare dhe gjuhësore siç e ka sot. Kështu, kryengritjen e vitit 1821, fuqitë e mëdha evropiane e

shfrytëzuan duke i pagëzuar kryengritësit me emrin e përbashkët grekë për të realizuar Greqinë politike të sotme. Pra, të gjithë kryengritësit e vitit 1821, arvanitasit, helenasit, vllahët dhe bullgarët, në mënyrë të barabartë, pas krijimit të mbretërisë dhe më vonë të shtetit grek, morën emrin e përbashkët politik kombëtar; grek. Vetë helenasit, në shekullin XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, parapëlqenin të quheshin romei dhe gjuhën e tyre romaikis.

Në historiografinë botërore, dhe as në rrëfimin e historianëve grekë, nuk përmendet data e 15.01.1821, kur Kuvendi i Kapedanëve të Rumelisë shpalli “Aleancën e Bashkimit Kombëtar” të shqiptarëve, për nisjen e luftës çlirimtare me thirrjen: “Nderin dhe Kombin i kemi bashkë – Të krishterë e myslymanë!”. Është i vetmi organizëm luftarak, i cili filloi dhe drejtoi luftën çlirimtare të 1821-it në tokën e Greqisë së ardhshme.

Dita kombëtare e Greqisë, 25 marsi 1821, që njihet nga historiografia botërore si datë e bekimit në manastirin e Aghia Lavres, të kryengritësve “grekë” nga arqipeshkvi i Patrës, Germanos, është një sajese e mëvonshme. Propaganduesi më i madh i kësaj date ka qënë F. Pukëvili, i cili donte t’i jepte kryengritjes së 1821 ngjyrën kristiane. Madje, është i njohur fakti që prelatët kishtarë, si Patriarku Grigoris, kanë mallkuar revolucionin dhe kryengritësit që e vinin në rrezik kishën ortodokse. Arsyeja sipas historianëve grekë ishte se kodi fetar nuk përfshin revolucionin.

“Revolucioni është një gjë e keqe, nuk është në dëshirën e Zotit të ngrihesh dhe të shkaktosh trazira.”

Pra, kryengritësit, nuk u frymëzuan nga “bekimet” dhe “meshat” e fshehta, por nga kuvendet e kapedanëve arbër që u bënë thirrje të gjithë banorëve pa dallim feje dhe race, për të luftuar sundimin 400 vjeçar otoman. Fitoret e luftëtarëve arbër kundër ushtrisë osmane dhe detyrat që dhanë Fuqitë e Mëdha, ndryshuan interesat e kishës, e cila pas formimit të shtetit grek, i cili ishte produkt i një revolucioni, duhet të vendoste edhe kishën si pjesë e këtij revolucioni. Kështu nisi sajimi i domosdoshëm i historisë rreth rolit të kishës ortodokse në revolucionin e 1821-it. Shprehja “grek-i krishterë”, e cila nuk njihet para vitit 1821, u bë baza ideologjike e shtetit të ardhshëm helen dhe programit të “megalo-idesë”.

Por, sa gjak shqiptari është derdhur vetëm gjatë luftës çlirimtare të 1821-it dhe dy luftave civile?

Nuk ka asnjë të dhënë. Revolucionin si të gjitha kryengritjet e armatosura është një histori e përgjakur. Shfarosjet dhe hakmarrjet, epidemitë dhe uria, luftëra civile dhe vrasje, plaçkitje, refugjate dhe skllavëri, këto janë tabloja e revolucionit dhe rrjedhojat e tij. Masakrat e bujshme të Psarës, Kios, Tripolicës dhe gjatë të gjithë periudhës së luftës, që prekën zemrat e intelektualëve më të shquar evropianë për nga mizoria, përmendin “grekë” dhe “turq”, ndërkohë që viktimat, me të dyja

emërtimet, qenë në shumicë, thjesht shqiptare, sepse mëkati më i madh i tyre, ishte mospërfshirja në trupin e helenizmit.

Disa nga arvanitasit heronj të kryengritjes së vitit 1821, ishin: Gjeorgjio Kundurioti, Kiço Xhavella, Andoni Kryezi, Teodor Kollokotroni, Marko Boçari, Noti Boçari, Kiço Boçari, Dhaskalina Bubulina, Anastas Gjirokastriti, Dhimitër Vulgari, Kostandin Kanari, Gjeorgjio Karaiskaqi, Odise Andruço, Andrea Miauli, Teodor Griva, Dhimitër Plaputa, Nikolao Kryezoti, Athanasio Shkurtanioti, Hasan Bellushi, Tahir Abazi, Ago Myhyrdani, Sulejman Meto, Gjeko Bei, Myrto Çali, Ago Vasiari dhe shumë e shumë shqiptarë të tjerë. Për mohimin e ndihmesës së arvanitasve në krijimin e shtetit grek, fillimisht u mohua raca, gjuha shqipe dhe çdo dorëshkrim i vjetër shqip i shkruar me shkronja greke u konservua, për të mos dalë më kurrë dhe për t’i mbuluar përgjithmonë pluhuri i harresës.

Në kujtimet e tij, Kollokotroni me të drejtë do të thotë: “Më vunë 9 muaj burg, pa parë askënd, përveç gardianëve. Kaq muaj nuk e dija ç’ndodhte jashtë, kush vdes, kë tjetër kanë burgosur. Nuk e dija përse më kishin burgosur. Kurrë nuk besoja se do të arrijnë në këtë shkallë të sajornë dëshmitarë të rremë...”

Avokati mbrojtës Klonari, tha në fjalën e tij: “Deri kur zotërinj gjykatës do të vazhdoni këtë sulmim barbar? Deri kur përndjekja e pamëshirshme kundër atyre që çliruan, i ngritën

lavdinë dhe vazhdojnë t’i japin shkëlqim Greqisë...?”

Publicisti dhe orientalisti austriak Jakob Philipp Fallmerayer ka thënë: “Revolucioni për pavarësinë e Greqisë ishte një revolucion shqiptar dhe jo grek.” Por, grekët janë të zënë duke vjedhur historinë e shqiptarëve dhe për këtë arsye ata nuk e dinë se kush kanë qënë banorët e parë të tyre.

## Kush mund të jenë krijuesit e vërtetë të tyre?

Politikani dhe historiani i njohur italian, Pietro Scopola duke patur parasysh, të gjithë ata të cilëve “u ka mbetur ora në shekullin XIX”, i këshillon të studiojnë historinë e kaluar, sepse të dish se çfarë ka ndodhur, shërben për të ditur se kush jemi dhe “rikujtimi i të vërtetave historike është një akt, që qëndron në themel të paqimit të popujve”.

Fakti që tashmë nuk mund të diskutohet, megjithëse deri tani pjesërisht ishte fshehur që 90 ndër 100 heronjtë e Revolucionit të 1821, ishin arvanitë ose më mirë shqiptarë. Që arvanitasit mbajtën peshën kryesore të luftës çlirimtare të 1821, përveç që ishin pjesa dërrmuese e popullit grek në periudhat e kryengritjes, mund të shpjegohet edhe nga fakti që arvanitët ishin një popull luftarak, krenaria e të cilit nuk mund të lejonte poshtrimet e skllavërisë. Revolucionin e 1821, ishte kryesisht në themel vepër e arvanitasve të Çamërisë, Rumelisë, Moresë dhe e arvanitasve të ishujve të Hidrës, Specësit, dhe Psarës. Populli arban ose shqiptar në çdo vend të



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Inverti  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com




## Hoxha: Jam në kulmin e karrierës sime

Zagreb, 8 maj - Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Arbër Hoxha, ia siguroi fitoren e madhe skuadrës së tij, Dinamo Zagreb, në përballje me Rijekën (1-2), duke shënuar në minutën e parafundit të ndeshjes. Futbollisti nga Kosova mund të thuhet se i dha gjigantit kroat të

futbollit titullin e 7 radhazi. 25-vjeçari ka thënë se ky është momenti më i mirë në karrierën e tij. "Natyrishë që jam shumë i kënaqur për golin, por edhe për fitoren e skuadrës. Nuk luajtëm mirë në pjesën e parë, por pas pushimit bëmë ndryshime në formacion. E vërtetë që goli që

pësuam me penallti na tronditi, por më pas treguam karakterin dhe kthyem rezultatit në 2-1. Padyshim që ky është momenti më i mirë i karrierës sime, sepse e ndihmova ekipin në një fitore për titullin. Kjo është shumë e rëndësishme për mua, për klubin dhe natyrishë për të

ardhmen", u shpreh Hoxha. Arbër Hoxha lufton ta sigurojë Kampionatin Evropian me Kombëtaren shqiptare, diçka që bëhet më e lehtë kur luan për një skuadër si Dinamo Zagreb, skuadër e cila ka fituar plot 11 tituj në Kroaci në 12 vitet e fundit.



## Trepça - Ylli, sonte finalja e parë

MITROVICË, 8 MAJ - Trepça dhe Golden Eagle Ylli, pas një rrugëtimi të gjatë, do t'i kenë sfidat vendimtare për titullin e kampionit. Trepça e kërkon titullin e pestë në histori të saj dhe të parin pas vitit 2012, ndërkohë që therandasit titullin e tretë në histori, pasi e kanë fituar më 2021 dhe 2022. Mitrovicasit kanë pasur një edicion mjaft të suksesshëm deri më tani, duke fituar Kupën, Superkupën dhe Ligën Unike. Pikërisht në finale të Ligës Unike fituan ndaj Yllit, në një sfidë shumë interesante që përfundoi 66:67 për "Xehetarët". Trepça përfundoi edicionin e rregullt në vendin e parë me 25 fitore e tri humbje, derisa therandasit në vendin e tretë me 19 fitore e tri humbje. Nga tri humbjet e Trepçës, dy kanë ardhur nga Ylli, duke paralajmëruar një sfidë shumë të "zjarrtë" mes tyre. Trepça në gjysmëfinale eliminoi Sigal

### ORARI I FINALEVE

9 MAJ  
19:00 TREPÇA - GOLDEN EAGLE YLLI

12 MAJ  
19:00 GOLDEN EAGLE YLLI - TREPÇA

16 MAJ  
19:00 TREPÇA - GOLDEN EAGLE YLLI

19 MAJ  
19:00 GOLDEN EAGLE YLLI - TREPÇA (E MUNDSHME)

23 MAJ  
19:00 TREPÇA - GOLDEN EAGLE YLLI (E MUNDSHME)

Prishtinën 3:0, ndërsa Golden Eagle Ylli në çerekfinale mundi Bashkimin 2:0 dhe Pejën në gjysmëfinale 3:2. Takimi zhvillohet sonte (e enjte) nga ora 19:00 në "Minatori" dhe transmetohet në Art Motion/Kujtesa. Skuadra që shënon tri fitore do të shpallet kampione e Kosovës.

PLAY OFF 2024  
**FINALJA I**  
 9 MAJ - 19:00  
 TREPÇA VS GOLDEN EAGLE YLLI  
 PRINCE SUPERLIGA KOSOVA

## Enis Kabashi i jep fund karrierës në hendboll



PRISHTINË, 8 MAJ - Repreruesi shumëvjeçar i Kosovës, Enis Kabashi, ka vendosur t'i japë fund karrierës si hendbollist. Por 33-vjeçari do të mbetet në sportin e hendbollit. Kabashi ka pasur karrierë shumë të suksesshme si hendbollist. Ka nisur te Trepça, ndërsa për shumë vjet ishte te Prishtina, po ashtu te Besa e Pejës. Ka fituar shumë trofe në hendbollin e Kosovës, ndërsa ishte edhe më i miri i vitit. Kabashi ka nëntë vjet që luan dhe vepron

në Gjermani. Prej fillimisht ishte te skuadra TG Landshut Handball, ku çmohet për kontributin e dhënë. "Jam tërhequr nga hendbolli aktiv. E kam kryer provimin për trajner të nivelit C në Gjermani dhe jam duke e ushtruar ekipin U18 të klubit gjerman Landshut. Klubin ku kam luajtur plot nëntë vjet po e lë në moment shumë të mirë. Jemi bërë kampione këtë edicion dhe kemi hyrë në ligën e tretë gjermane. Në ligën e tretë niveli është më i lartë

dhe duhet të udhëtohet goxha larg. Edhe lëndimet që i kam pasur janë prej arsyeve që kam vendosur t'i jap fund karrierës si lojtar. Hyrja në ligën e tretë ishte synimi kryesor prej që kam ardhur dhe jam i lumtur që ia dolëm", ka thënë Kabashi. Federata e Hendbollit e Kosovës e falënderon Enisin për kontributin shumëvjeçar në hendbollin tonë dhe në Kombëtaren e Kosovës, ndërsa i dëshiron suksese në karrierën si trajner.

## Fetahu dhe Dushku do të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës

PRISHTINË, 8 MAJ - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, do të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës. Asambleja e Përgjithshme e

FIBA Evropës do të mbahet në Portoroz të Sllovenisë më 11 maj. Në Asamblenë e Përgjithshme të FIBA Evropës do të diskutohet për tema të rëndësishme për basketbollin ndërkombëtar. Më 10 maj, po në Portoroz të

Sllovenisë, do të mbahet Mbledhja e Bordit të FIBA Evropës, ku do të marrë pjesë edhe i pari i basketbollit të Kosovës. Kjo do të jetë mbledhja e katërt për Fetahun si anëtar i Bordit të FIBA Evropës.

Fetahu është zgjedhur anëtar i Bordit të FIBA Evropës në maj të vitit të kaluar. Dushku do të marrë pjesë në takimin e sekretarëve të përgjithshëm të federatave anëtare të FIBA Europes, që zhvillohet më 10 maj.





## Hamiltoni: Dua ta fitoj Botërorin e tetë

**SHTUTTGART, 8 MAJ** - Nuk mund të mungonte në eventin mondan më të pritur të vitit. Lewis Hamiltoni ishte mes protagonistëve të mëdhenj në "Met Gala", mbrëmjen e mbledhjes së fondeve të organizuar në Metropolitan Museum të New York-ut nga e përjavshmja "Vogue America".

Një festë ekskluzive, ku marrin pjesë 400 të ftuar çdo vit, dhe ku Sir Lewis u prezantua me një veshje të tërën të zeze, të ideuar nga Burberry. "Met Gala" ishte dhe rasti për të folur për Formula 1 dhe për programet e të ardhmes që e shikon të angazhuar me Ferrarin: "Çfarë do të bëj pas

garave? Për momentin nuk mendoj asgjë, pasi dua të fitoj Botërorin e tetë ose të paktën të luftoj për këtë objektiv. Ka qenë e vështirë në këto vite. Nuk mund të shkonte më keq. Natyrisht ne jemi në Formula 1 për të fituar dhe, kur nuk ia del, perspektiva ndryshon. Aventura te Mercedesi ka qenë

emocionuese, por nuk po ik pasi nuk jam i lumtur apo për problem raportesh. Më kanë mbështetur që kur isha 13 vjeç. E dua markën dhe personat që jetojnë aty. Kanë qenë me mua në të mirë dhe në të keq, por vjen një moment kur duhet të ndryshosh".



## Hummels: Tani duam trofeun

**DORTMUND, 8 MAJ** - Mats Hummels, për herë të dytë radhazi, u shpall lojtari i ndeshjes. "Diga" gjermane zhvilloi një ndeshje perfekte, futi në "xhep" Kylian Mbappe, ndërsa me golin e tij i dhuroi Borussia Dortmundit një biletë për në finalen e Ligës së Kampionëve. Pas 11 vitesh, Hummels rikthehet sërish në finale, por në moshën 35 vjeçare u ngjiti në podium si lojtari i tretë më i vjetër që realizon një gol në fazën gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Mediat nuk i kursyen elozhet për Hummels, pjesa e tyre më e madhe e vlerësuan me notën 10, kjo pasi Hummels ishte thjesht perfekt. Qendërmbrojtësi shpreson që tani fundi të jetë i lumtur, ëndërron të ngrejë në qiell kupën me veshë të mëdhenj. "Kam



shënuar shumë pak gola në karrierën time në Ligën e Kampionëve, vetëm pesë, ky ishte momenti i duhur për të shënuar. Që nga sfida e kthimit kundër Milanit në fazën e grupeve kemi menduar gjithnjë se mund të

fitonim kundër të gjithëve, tani nuk shoh asnjë pengesë pse të mos fitojmë edhe në 'Wembley'. Këtu zhvilluam ndeshjen tonë, atmosfera ishte fantastike fal tifozëve tanë të mrekullueshëm", u shpreh Hummels.

### SHKURT

#### Gazetari italian: Broja largohet nga Chelsea këtë verë

Armando Broja do të largohet përfundimisht nga Chelsea këtë verë. Ky lajm është bërë publik nga gazetari i njohur i futbollit, Fabrizio Romano, i cili përmes rrjeteve sociale bën me dije se Broja do ta vazhdojë karrierën larg "Bluve" të Londrës. Momentalisht sulmuesi i kombëtares shqiptare të futbollit ndodhet në formë huazimi te Fulhami deri në verë, ku edhe aty minutat për të kanë qenë të pakta. Menjëherë sapo ta përfundojë huazimin Broja do të vendosë ku do ta vazhdojë karrierën, ndërsa për shqiptarin interes kanë shfaqur disa klube në Premierë Ligë, por edhe në kampionatet e tjera elitare të Evropës.

#### Sparta Pragë ofron 2.5 milionë euro për Rrahmanin

Forma e lartë që po shfaq këtë edicion në elitën e futbollit rumun sulmuesi Albion Rrahmani ka bërë që zërat për largimin e tij nga Rapid Bukureshti të shtohen shumë teksa po i afrohem hapjes së afatit kalimtar veror. Në 23 ndeshje të luajtura gjatë këtij sezoni me Rapidin, Rrahmani ka qenë autor i 17 golave, teksa ka kontribuar edhe me katër asistime. Largimin e Rrahmanit në verë nga klubi rumun tashmë një muaj më herët e kishte konfirmuar edhe ish-trajneri i Rapidit, Cristiano Bergodi, i cili kishte thënë se shumë ekiye kanë shprehur interesim për shërbimet e tij. Tani klubi i radhës që po raportohet se ka shprehur interesim për transferimin e 23-vjeçarit është gjiganti çek Sparta Praga. Sipas asaj që raporton mediumi çek "dznes.cz", Sparta është e gatshme të ofrojë 2.5 milionë euro për shërbimet e Rrahmanit, por siç shton raportin, Rapidit e vlerëson kartonin e tij shumë. Nga Rumania kanë raportuar se Rapidit po tenton të përfitojë të paktën 8.5 milionë euro nga shitja e Rrahmanit, që do ta bënte atë lojtarin më të shtrenjtë në histori të klubit çek. Kujtojmë se më herët është raportuar se interesim për Rrahmanin kanë shprehur edhe ekipet si Benfica dhe Aston Villa.

#### Unitedi vendos për të ardhmen e Ten Hagenit

Aventura e trajnerit Erik ten Hag te skuadra e Manchester Unitedit është drejt fundit. Sipas "Daily Mail", klubi ka marrë vendim për trajnerin holandez. Ten Hagut do t'i komunikohet largimi nga "Old Trafford", por kjo gjë do të ndodhë pas finales së FA Cup, ku "Djajtë e Kuq" do të përballen me Manchester Cityn. Humbja turpëruese 0-4 ndaj Crystal Palace i ka vënë kapakun një sezoni zhgënjyes për Manchester Unitedin, që rrezikon të mos luajë në Evropë sezonin tjetër. Për këtë arsye, klubi ka vendosur ta largojë Ten Hagun pas vetëm dy sezonesh. Ende nuk dihet se cili do të jetë pasuesi i tij edhe pse janë përmendur shumë kandidatë.

## Bostoni bën detyrën ndaj Clevelandit, Oklahoma 'leksion' Dallasit

**BOSTON, 8 MAJ** - Ekipi i Bostonit ka fituar me rezultat 120-95 ndaj Clevelandit në gjysmëfinalen e parë "play-off" mes tyre në Konferencën e Lindjes. Ndeshje pa shumë histori, komanduar nga Celticsi, që udhëheq 1-0 me ndeshje. Jaylen Brown me 32 pikë ishte shënuesi më i mirë për Bostonin, mbështetur edhe nga Derrick White me 25 pikë. Për miqtë, Donovan Mitchell realizoi 33 pikë, por që s'mjaftuan për ta shmangur humbjen. Në Konferencën e



Perëndimit, skuadra e Oklahomas e mundi me rezultat 117-95 Dallasin. Vendasit patën epërsi gjatë gjithë kohës, duke marrë kryesimin me ndeshje (1-0). Alaxander Shai me 29 pikë

ishite lider në fushë për skuadrën e Oklahomës, ndërkohë që 42 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Për Dallasin, Irvingu realizoi 20 pikë e Donqiqi 19, por që mbetën për statistikë.

#### KONFERENCA E LINDJES - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

New York - Indiana (1-0)  
Boston - Cleveland 120-95 (1-0)

#### KONFERENCA E PERËNDIMIT - GJYSMËFINALE "PLAY-OFF"

Denver - Minnesota (0-2)  
Oklahoma - Dallas 117-95 (1-0)

## Mourinho mund të rikthehet në Premierligë

Pas përfundimit të këtij sezoni rrugët e Manchester Unitedit me Erik ten Hag me shumë mundësi do të ndahen për shkak të krizës që ndodhet ekipi nën drejtimin e holandezit. Referuar kësaj situatë,

tashmë ka shumë pasardhës të mundshëm të Ten Hag në "Old Trafford", por në Manchester orët e fundit po përhapet një lajm i bujshëm që thekson se Jose Mourinho është gati të rikthehet në

stolin e "Djajve të Kuq". Ish-trajner i Unitedit nga viti 2016 deri në dhjetor 2018, kur u shkarkua dhe u zëvendësua nga Solskjaer, 61-vjeçari, sipas asaj që raportohet nga mediet britanike, do t'u kishte

thënë miqve dhe të njohurve më të afërt se do të dëshironte të ishte sërish trajner i Manchester Unitedit në të ardhmen. Në dy vjet e gjysmë në "Old Trafford", Mourinho arriti të fitojë një Evropa Ligë dhe një EFL

Cup. Që nga janari i 2024-s kur u largua nga Roma, Mourinho është pa punë dhe situata nga të dyja palët, si nga trajneri ashtu edhe nga klubi anglez, duket e përkryer për t'u ribashkuar.





### SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Mbikëqyrës i Lartë Bankar
<b>Grada e pozitës:</b>	pesë (5)
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	me afat të pacaktuar
<b>Departamenti:</b>	Mbikëqyrja Bankare
<b>Divizioni:</b>	Raportimi dhe Analizat
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqësi i Divizionit të Raportimit dhe Analizave

#### Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përpilon raportet vlerësuese dhe kuantitative, si dhe analizat periodike të performancës financiare të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve, konform qasjes së mbikëqyrjes së bazuar në rrezik;
- Monitoron për së afërmi performancën financiare, pozicionet e caktuara financiare të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve;
- Monitoron indikatorët e sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe përgatitë raporte vlerësuese lidhur me këta indikatorë;
- Përgatitë dhe përditëson në baza periodike modelin stres-test si dhe modele të tjera përkatëse;
- Sipas kërkesës së mbikëqyrësit merr pjesë në ekzaminimet në vend në banka, IMF dhe IFJB;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve;
- Përgatitë dhe rekomandon strategjitë mbikëqyrëse konform profilit të rrezikut të bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve të fokusuar në vend;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve, kërkesave nga ekzaminimet në vend dhe ekzaminimet nga jashtë, masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave, IMF-ve dhe IFJB-ve;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave tjera të punës;
- Përpilon dhe analizon të dhëna për të cilat krijon modele matematikore, të cilat pastaj përdoren për projeksione në raportimet që dalin nga departamenti i mbikëqyrjes bankare;
- Menaxhon dhe administron sistemet e brendshme të raportimit nga institucionet financiare;
- Duke përdorur SQL query dhe Power BI dizajnon raporte nga sistemi informatikë sipas kërkesave të departamentit;
- Mbledhë, agregon dhe bënë query nga të dhënat e pranuar për të cilat ofron rekomandime duke u bazuar në analiza e institucioneve financiare;
- Punon me akterët e brendshëm dhe të jashtëm ashtu që do të zhvillojë dhe analizojë nevojat e Business Intelligence (BI) brenda departamentit;
- Zhvillon zgjidhje për atë automatizuar "query" të përsëritshëm kompleks të cilat përdoren në sistemin informatikë të departamentit të mbikëqyrjes bankare;
- Hulumton mjete, korniza dhe mekanizma për analizim të të dhënave, të cilat i propozon për përdorim brenda departamentit;
- Përgatitë raporte të një rangu të gjerë të cilat përpilohen nga të dhëna që vijnë në formate të ndryshme dhe platforma të llojllojshme;
- Shërben si zyrtar ndërlidhës me departamentin e teknologjisë informative (TI-së) gjatë zhvillimit të sistemeve informatike të cilat kanë fokus departamentin e mbikëqyrjes bankare.
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi.

#### Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Të ketë të kryer fakultetin ekonomik, menaxhment, financa, kontabilitet, matematikë, informatikë;
- Të ketë minimum 3 vite përvojë pune profesionale në risk, financa, kontabilitet, auditim, teknologji informative, MIS apo të ngjashme;
- Njohuri të shquara analitike, të nevojshme për analiza financiare si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e menaxhimit të rreziqeve bankare në banka, IMF dhe IFJB;
- Kërkohen aftësi të shquara për vlerësime dhe vendimmarrje të pavarur nga mbikëqyrësit;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit gojor, komunikimit me shkrim, të dëgjimit dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Njohuri të mirë lidhur me SQL server përfshirë SQL queries;
- Njohuri të mira të Business Intelligence (BI);
- Njohja e mirë e Ms. Office;
- Njohja e mirë e Power BI;
- Aftësi të caktimit të prioriteteve të punës dhe të përmbushjes së afateve;
- Preferohet të ketë njohje të gjuhës angleze.

#### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuar zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

#### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **23 maj 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



### OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Naziv radnog mesta:</b>	viši bankarski službenik
<b>Stepen pozicije:</b>	pet (5)
<b>Trajanje radnog odnosa:</b>	na neodređeno
<b>Odeljenje:</b>	bankarski nadzor
<b>Odsek:</b>	izveštavanje i analize
<b>Izveštava:</b>	rukovodiocu Odseka za izveštavanje i analize

#### Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Sastavlja evaluativne i kvantitativne izveštaje, kao i periodične analize finansijskog poslovanja banaka, MFI i NBFi, u skladu sa pristupom nadzora zasnovanog na riziku;
- Izbliza prati finansijski učinak, specifične finansijske pozicije banaka, MFI i NBFi;
- Prati indikatore sistema ranog upozoravanja i priprema izveštaje o proceni u vezi sa ovim indikatorima;
- Priprema i periodično ažurira model stres testa kao i druge relevantne modele;
- Na zahtev nadzornika učestvuje u kontrolama na licu mesta u bankama, MFI i NBFi;
- Identifikuje rizike i obavezujuće radnje, kao i preporučuje prilagodavanje strategija za nadzor banaka, MFI i NBFi;
- Priprema i preporučuje strategije nadzora u skladu sa profilom rizika banaka, MFI i NBFi-a i preporučuje nadzorniku učestalost i obim kontrola fokusiranih na licu mesta;
- Prati provođenje preporuka, zahteva sa kontrola na licu mesta i spoljnih kontrola, obavezujućih mera izrečenih bankama, MFI i NBFi-ima;
- Pomaže u sastavljanju politika, propisa, uputstava i drugih radnih procedura;
- Obrađuje i analizira podatke za koje kreira matematičke modele, koji se zatim koriste za projekcije u izveštajima koje izdaje odeljenje za bankarski nadzor;
- Upravlja i administrira sistemima internog izveštavanja finansijskih institucija;
- Koristeći SQL query dhe Power BI dizajnira izveštaje iz informatičkog sistema prema zahtevima odeljenja;
- Prikuplja, agregira i postavlja upite iz primljenih podataka za koje daje preporuke na osnovu analize finansijskih institucija;
- Radi sa internim i eksternim zainteresovanim stranama na razvoju i analizi potreba Business Intelligence (BI) unutar odeljenja;
- Razvija rešenja za automatizovani složeni ponovljivi "query" koji se koriste u informatičkom sistemu odeljenja za bankarski nadzor;
- Istražuje alate, okvire i mehanizme za analizu podataka, koje predlaže za korišćenje unutar odeljenja;
- Priprema širok spektar izveštaja koji su sastavljeni od podataka koji dolaze u različitim formatima i različitim platformama;
- Služi kao službenik za vezu sa odeljenjem informacionih tehnologija (IT) tokom razvoja informatičkih sistema čiji je fokus na odeljenje za bankarski nadzor.
- Ostale dužnosti koje odredi nadzornik.

#### Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Da ima završen fakultet ekonomije, menadžmenta, finansija, računovodstva, matematike, informatike;
- Da poseduje najmanje godine profesionalnog radnog iskustva u riziku, finansijama, računovodstvu, reviziji, informatičkoj tehnologiji, MIS-u ili slično;
- Izvanredna analitička znanja neophodna za finansijsku analizu kao i za procenu adekvatnosti upravljanja bankarskim rizikom u bankama, MFI i NBFi;
- Od nadzornika se traže istaknute veštine za procenjivanje i sposobnost nezavisnog donošenja odluka;
- Potrebno je demonstrirati odličnu usmenu komunikaciju, pismenu komunikaciju, veštine slušanja i prezentacije nadzorniku i drugim stranama;
- Sposobnost efikasnog rada u timu; veštine upravljanja vremenom u vezi sa izvršenjem i kvalitetom radnih zadataka; sposobnost efikasnog rada sa nadzornikom i timom; sposobnost rada, diskusije i uveravanja sa spoljnim stranama;
- Dobro poznavanje SQL servera uključujući SQL queries;
- Dobro poznavanje Business Intelligence (BI);
- Dobro poznavanje Ms. Office;
- Dobro poznavanje Power BI;
- Sposobnost određivanja prioriteta u radu i poštovanja rokova;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

#### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK za prijavu;
- Propatno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti podataka o ličnosti);
- Izveštaj Kosovskog fonda penzione štednje (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda od Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta ne primenjuje zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

#### Postupak prijave:

- Rok za prijavu je **23 maj 2024**.
- Prijava se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične veb stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali načini za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti putem službene veb stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)







**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

